



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KA.nr.411/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Roefix”, shpk me seli në Serbi, kundër të paditurës Ministria e Drejtësisë, për shkak të anulimit të Vendimit 03/2016 të datës 22.02.2020, jashtë seancës, me datë 28.04.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET poshtë padia e paditësit “Roefix”, shpk me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Drejtësisë, për shkak të anulimit të Vendimit 03/2016 të datës 22.02.2020, si e paplotësuar.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

Paditësi “Roefix”, shpk me seli në Prishtinë, ka parashtruar padi kundër të paditurës Ministria e Drejtësisë, për shkak të anulimit të Vendimit 03/2016 të datës 22.02.2020. Paditësi ishte i përfaqësuar nga avokati A.I. i cili me parashtrëse të datës 06.01.2021 e ka revokuar autorizimin dhe ka propozuar që shkresat ti dërgohen ne adresë të paditësit në Serbi.

Gjykata me datë 07.01.2024 e ka ftuar paditësin përmes paditësit përmes shpalljes në tabelë që të caktoj përfaqësues për pranimin e shkresave konform Neni 118 të LPK-së, ku përcaktohet:

*118.2 Paditësin apo përfaqësuesin e tij ligjor që ndodhët në botën e jashtme, që nuk kanë përfaqësues në Kosovë, gjykata, që me rastin e dërgimit të shkresës së parë, i thërret që brenda afatit të caktuar të emërojnë përfaqësuesin për marrjen e shkresave në Kosovë, me kërcënim se në të kundërtën gjykata*

*paditësit, me shpenzime të tij, do t'ia emëroj edhe përfaqësuesin për marrjen e shkresave nëpërmjet të cilit do të lajmërohet paditësi, gjegjësisht përfaqësuesi i tij, për emërimin e bërë në këtë mënyrë. 118.3 Palës që e revokon përfaqësuesin për pranimin e shkresave, pa e caktuar një përfaqësues tjetër për një gjë të tillë, gjykata ia komunikon shkresat duke i afishuar ato në tabelën e shpalljeve në gjykatë, derisa pala e tillë ta caktojë përfaqësuesin tjetër për pranimin e shkresave.*

Duke vepruar konform Nenit 114 të LPK, ku përcaktohet se *në qoftë se dorëzimi i shkresës subjektit të regjistruar në regjistrin publik nuk mund t'i bëhet në adresën e treguar në regjistër, komunikimi bëhet duke u ngjitur shkresa në tabelën e shpalljeve të gjykatës, dorëzimi konsiderohet i kryer pas skadimit të afatit prej shtatë ditësh nga dita e afishimit në tabelën e shpalljeve të gjykatës, gjykata me datë 14.03.2024 publikoj thirrjen për plotësim të padisë me adresë të saktë të paditësit, konform nenit 99 dhe nenit 253 të LPK dhe për pagesë të taksës e cila qëndroj e publikuar 7 ditë, dhe edhe pas kalimit të afatit prej 8 ditëve gjykata nuk ka pranuar të dhënat e kërkuara e që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës.*

Andaj, bazuar në Ligjin për Konfliktet Administrative, nenit 33 nenit 33, Nëse padia nuk është e plotë, është e pakuptueshme ose ka të meta, kryetari i kolegjit do të ftojë paditësin, që: *brenda afatit prej tetë (8) ditëve t'i mënjanojë të metat e padisë. Në ftesë duhet të ceken udhëzimet për të mënjeluar të metat e padisë dhe paralajmërimi për pasojat që do të lindin nëse nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës, dhe Nëse paditësi, brenda afatit të cekur, nuk i mënjanon të metat e padisë, kurse ato janë të atilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata do ta hedhë poshtë me vendim padinë, nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.*

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

Ka.nr.411/22, datë 28.03.2024

Gjyqtarja  
Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLA JURIDIKE :** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.